REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 49/23
Datë/Datum. 02.02.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Florije Rexhepi	**24.01.2023**	**02.02.2023**	***49/23***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **20.01.2023**, OE "El-BAU", ka parashtruar ankesë me nr.: 49/23, kundër njoftimit për kontratë, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "***Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish***", me nr. të prokurimit: 651-22-11628-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KOMUNA GJILAN.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:
Data e njoftimit për kontratë.....14.11.2022
Hapja e ofertave..... 05.12.2022
Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së B58.....11.01.2023

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE TË OE

Dispozitat e shkelura

Neni 1 paragrafi 2 i LPP-së;
Neni 10 dhe 11 i LPP-së;

Neni 62 paragrafi 1.1 i LPP-së;
Neni 4.3 i RRPP Nr.001/2022;
Neni 40.3 i RRPP nr. 001/2022;
Neni 43.5 pika i e RRPP nr.001/2022;
Neni 4,6,7,8 dhe neni 48 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Historia procedurale e çështjes së aktivitetit në fjalë.

Parashtruesi i Kërkesës për Rishqyrtim OE "EL BAU" Sh.p.k ka qenë ofertues në tenderin e shpallur në procedurë të hapur nga Komuna e Gjilanit me titull: ***Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish"*** dhe me numër prokurimi **651-22-11628-5-2-1,** të publikuar me datën 15.11.2022 në platformën e-prokurimi.

Parashtruesi i Kërkesës për Rishqyrtim OE "EL BAU" Sh.p.k. ka konkuruar në këtë tender brenda afatit për dorëzimin e ofertave dt. 05.12.2022 dhe në tërësi i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe kriterin e dhënies së kontratës të tenderuesit të përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Mirëpo përkundër se pas përfundimit të procesit të vlerësimit të tenderëve, kishte kaluar afati i rregullt ligjor prej 30 ditësh për vlerësimin e tenderëve, dhe nxjerrjen e njoftimit mbi vendimin e AK-së, dhe kur pritej ndjekja e hapave ligjorë që pasojnë pas përfundimit të procesit të vlerësimit, nga ana e juaj si AK duke vepruar në shkelje thelbësore të dispozitave të legjislacionit të prokurimit, me datën 11.01.2022 është nxjerr vendimi i paligjshëm me anë të cilit keni anuluar aktivitetin e prokurimit me shkaqe të paqena dhe të pabazueshme. Arsyetimi referohet në justifikimin se gjoja paska ndodhur një gabim i pariparueshëm në listën e përshkrimit të çmimeve – paramasës dhe parallogarisë **gjë që nuk është e vërtetë për faktin se një gjë e tillë nuk ka ndodhur pasi nuk ka asnjë gabim të tillë paramasë gjegjësisht përshkrimit të qmimeve.**

Në këtë mënyrë me veprimet e paligjshme të AK-së neve si OE po na shkaktohen dëme të konsiderueshme materiale në të gjitha aspektet, pasi AK-së po i ndodh shpesh e besa e ka bërë si fenomen/praktikë që t'i anulojë aktivitetet pas fazës së vlerësimit të tenderëve mbi bazën e sajimit të supozimeve dhe imagjinatave përmes paraqitjes së fakteve/situatave të paqena/rrejshme. E aq me tepër edhe sikur të kishte situata të tilla të arsyeshme dhe besueshme, ato janë brenda kontrollit/përgjegjësisë së AK-së dhe kështu që për gabime të tilla do të duhej të mirreshin masa para hapjes së tenderëve dhe në asnjë rrethanë në fazën kur OE e përgjegjshëm priten të shpërblehen me kontratë.

Andaj duke qenë se arsyetimi i vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit nuk përkon aspak me gjendjen faktike, si palë me interes material nga rezultati u këtij aktiviteti të prokurimit, kundër këtij vendimi parashtrojmë Kërkesë për Rishqyrtim duke paraqitur dhe argumentuar në mënyrë të qartë faktet dhe rrethanat e mbështetura me prova që sdëshmojnë se AK me anulimin e aktivitetit ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme.

Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimi Nr.1.

Me datën 11.01.2023, AK – Komuna e Gjilanit gjersa ishte në fazën e vlerësimit të tenderëve bënë anulimin e aktivitetit të prokurimit përmes Njoftim mbi Vendimin e AK-së me arsyetimin gjoja se AK pas hapjes së ofertave paska paska konstatuar një gabim të pariparuesheëm tek lista e përshkrimit të çmimeve – paramasës dhe parallogarisë.

Në pikpamje faktike dhe ligjore arsyetimi për anulim nuk qëndron në mënyrën e paraqitur, sepse mënyra e paraqitur paraqet supozime dhe imagjinim të situatave të paqena/joreale dhe jo gjendjen e saktë faktike dhe kërkesat ligjore për faktin se nuk ka asnjë gabim në listën e përshkrimit të çmimeve – paramasës dhe parallogarisë. **Është absolutisht e pamundur të vërtetohet se ka ndodh diçka, e cila nuk ka ndodh. Justifikimi i marrë shkas nga AK për anulim të aktivitetit është i pabazuar, rrjedhimisht nuk mund të argumentohet/provohet me asnjë provë relevante.**
Aq më tepër po të ishte ky gabim siç është thënë, AK-ja do të duhej që ta qartësonte dhe sqaronte se ku dhe në cilën pjesë saktësisht ndohet gabimi dhe jo të mirrej si pretekst një arsyetim i shpikur/imagjinuar dhe i paprovuar si shkak tendencioz dhe i njëanshëm për anulimin e aktivitetit të prokurimit gjersa procesi ishte në fazën përfundimtare – dhënien e kontratës.

Të jemi real, e verteta është ndryshe, sepse siq e potencuam nuk ka asnjë gabim siç është paraqitur nga AK-ja dhe asnjë arsyetim të bazuar për anulim të aktivitetit. Megjithatë është e dukshme në mënyrë shumë të kjartë se në rekapitullimin (Krahu 1, Krahu 2 dhe Krahu 3) të paramasës ka pasur një lëshim të vogël teknik si pasojë e të cilit përllogaritja/mbledhja e rekapitullimit në mënyrë automatike përmes formulës së mbledhjes në excel ka përfshi vetëm rekapitullimin e Krahut 1 dhe Krahut 2 e jo edhe rekapitullimin e Krahut 3.
Në këtë mënyrë përllogaritja/mbledhja për rekapitullimin e tri krahëve (Krahu 1, Krahu 2 dhe Krahu 3) është dashur që të bëhet në formë teknike apo që përllogaritja për të tri krahët të bëhet në mënyrë automatike duke qenë të vëmendshëm që të shtohet në formulë edhe shifrën për rekapitullimin e krahut 3 siç është vepruar nga ana jonë duke rxjerrur çmimin e saktë total për rekapitullimin e tre krahëve të paramasës. Në këtë kuptim nuk ka asnjë mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë si dhe çmimit total të shumëzuar në rekapitullimin e paramasës dhe parallogarisë. E aq më tepër nuk ka asnjë gabim aritmetik që ndryshon çmimet në sasi dhe njësi

AK-ja është në dijeni se lëshime të njejta teknike kanë ndodhur edhe më përpara në shumë aktivitete tjera mirëpo nuk është asnjë rast i vetëm që aktiviteti është anuluar për një gabim të tillë teknik i cili nuk e ndryshon kushtin material.

Prandaj, në rastet si ky AK përdor standarde të dyfishta, kur në vendimin e kundërshtuar paraqitet pasqyrim i gabuar i gjendjes faktike dhe që nuk përkon me realitetin, duke ngritë versione me supozime të pabaza, atëherë vie deri të ngatrrimet si të atyre në përshkrimin e gjendjes faktike, përshkrimin ligjor, duke ngatërruar gabimin kinse të shkaktuar, më qëllim që të ipet përshtyja që diçka e paligjshme paska ndodhur.

Së dyti, përkundër se nuk egziston fare gabimi në të cilin është thirrur AK-ja, nuk nuk qëndron i bazuar në mënyrën e paraqitur as justifikimi se kinse pas hapjes së ofertave na çenka konstatuar *"gabimi te lista e përshkrimit të çmimeve -paramasës dhe parallogarisë"* i cili është shpikur dhe përdorur për anulim për arsyet që i din zyrtarja përgjegjëse e prokurimit. Se ky konstatim është i pavërtetë dëshhmohet me faktin se procesi i hapjes së tenderëve ka ndodhur me datën 05.12.2022 ndërsa vendimi për anulim është nxjerrë me datë 11.01.2023 që i bie 37 ditë pas hapjes së ofertave.

Së treti, duhet të potencohet pasiguria juridike që po shkaktohet nga zyrtarja përgjegjëse e prokurimit në Komunën e Gjilanit e cila e ka bërë praktikë/fenomen që t'i anulojë aktivitetet pas fazës së vlerësimit të tenderëve mbi bazën situatave të paqena dhe të paligjshme zakonisht gjersa procesi ndodhet në fazën e dhënies së kontratës. E aq më tepër edhe sikur këto situata të ishin të arsyeshme e të besueshme, meqenëse janë brenda kontrollit/përgjegjësisë së AK-së, masat për gabime të tilla eventuale do të duhej të mirreshin para hapjes së tenderëve dhe në asnjë rrethanë në fazën kur OE e përgjegjshëm priten të shpërblehen me kontratë.

Për rikujtimin e zyrtarës përgjegjëse të prokurimit, legjislacioni i prokurimit në fuqi për secilin nga hapat e procesit të prokurimi ka sqaruar dhe përcaktuar në mënyrë të qartë veprimet që duhet të ndërmirren nga ana e AK përkitazi me një proces të prokurimit duke përfshirë edhe kohën kur këto veprime duhet të ndërmirren. Në rastin konkret duke ju referuar hapit të katërt – përgaditjes së dosjes së tenderit, neni 17.12 i RRPP e përcakton shumë qartë se çfarë duhet të përmbajë dosja e tenderit, ku shprehimisht thuhet:

"Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratës në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë". **Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes së tenderit.**

Po ashtu legjislacioni i prokurimit ka lënë në diskrecion të AK-së edhe korrigjimin e dosjes së tenderit para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Në këtë kuptim, në dosjen e tenderit të aktivitetit në fjalë është përcaktuar mundësia e korrigjimit të dosjes së tenderit nga ana e AK-së është përcaktuar në nenin 17 të dosjes në çdo kohë para skadimit të afatit për dorëzim të tenderëve.
Në rastin konkret nga ana e AK-së nuk është paraqitur asnjë kërkesë për korrigjim të dosjes së tenderit para skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve që ishte data 05.12.2022 por as pas këtij afati. E aq më tepër duke e ditur se ky lëshim teknik është vazhdimësi e shumicës së aktiviteteve paraprake të prokurimit e që nuk e ka korrigjuar asnjëherë. Po ashtu nuk ka pasur asnjë veprim për anulim menjëherë pas procesit të hapjes së tenderëve siç ka pohuar rrejshëm AK në arsyetimin e vendimit të kontestuar.

Nga të gjitha këto prova relevante të bazuara në gjendjen faktike dhe kërkesat ligjore të legjislacionit të zbatueshëm të prokurimit vihet në përfundim se vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit ka qenë në tërësi i paligjshëm. E aq më tepër, justifikimet në të cilat është thirrur AK janë imagjinata të mbështetura me paragjykime e supozime si pretekst për anulim arbitrar të aktivitetit me qëllim që paditësit t'i pamundësohet realizimi i kontratës të fituar më parë nga një proces i rregullt ligjor nga vet AK-ja.
Andaj në rastin konkret në pikpamje faktike dhe ligjore nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet e nenit 62 të LPP-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Dispozita ligjore e nenit 62 paragrafi 1.1 të LPP-së në të cilën është thirrur AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit, nuk qëndron për faktin se kjo dispozitë është keqinterpretuar apo zbatuar në mënyrë të gabueshme. Ndërsa baza e arsyetimit nuk qëndron, sepse mënyra e paraqitur paraqet supozime dhe imagjinim të situatave të joreale dhe jo gjendjen e saktë faktike. Dhe për më tepër nuk ka asnjë ngjarje objektive që është jashtë kontrollit të AK dhe që nuk ka mundur të parashikohet pasi që aktiviteti ka kaluar në mënyrë të ligjshme në të gjitha stadet e procedurës.

Në këtë mënyrë, AK ka shkelur dispozitat e ligjit material nga neni 62 i LPP-së lidhur me dispozitat e legjislacionit sekondar nga neni 43.5 pika i) të RRPP nr.001/2022.

Pretendimi Nr.2.

Edhe në këtë rast si në aktivitete tjera nga ana e AK-së procesi për vlerësimin e tenderëve dhe nxjerrja përfundimtare e vendimit të AK-së nuk ka përfunduar brenda afateve të rregullta ligjore, jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Nga procesi për hapjen e tendërëve dt. 05.12.2022 deri te nxjerrja e vendimit për anulim tëaktivitetit procesi ka zgjatur 37 ditë.

Dispozita e nenit nenin 40 par.3 të Rregullorës në fuqi me Nr.001/2022, qartë ka përcaktuar se sa duhet të jetë afati kohor për procedurën e vlerësimit dhe nxjerrjes së njoftim vendimit të AK-së: *Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.*
Nga ana e AK-së është bërë më e pritshme të ndodhin befasi të papritura që janë në kundërshtim me pritshmëritë ligjore. Përkundër faktit se është tejkaluar afati ligjor për vlerësimin e tenderëve dhe nxjerrja përfundimtare e vendimit të AK-së, në përfundim procesi nuk ka përfunduar sipas pritshmërive ligjore mirëpo është sajuar një arsye tendencioze si pretekst për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Në këtë mënyrë, konsiderojmë se AK ka shkelur nenin 40.3 i RRPP nr.001/2022.

Pretendimi Nr.3.

Me daten 11.01.2022 pasi që kemi pranuar vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit kemi kërkuar qasje në dokumentet te cilat kane te bejne me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugeve ne fshatin Gadish".

AK- Komuna e Gjilanit e ka aprovuar kërkesën për qasje, mirëpo përkundër këtij fakti ne praktike kur kemi shkuar, qasja nuk na eshte lejuar siç kemi kerkuar dhe e përcakton neni 10 dhe 11 te LPP-se në rastet kur ka dokumente si sekret afarist. Qasja ne dosjet e tenderuesve nuk na eshte siguruar me arsyetimin se nga ana e tyre eshte parashtruar kerkese per sekret afarist. Mirëpo me aq sa kemi parë me sy Kërkesën për sekret afarist të dosjes së tenderit të OE "Company Zuka" dhe OE "Tali" në asnjërën prej kërkesave të tyre nuk jane identifikuar/referuar dokumentet apo informacionet si sekrete afarist e po ashtu nuk jane dhene arsyet pse duhet te konsiderohen si sekret afarist dhe natyren e demit te tille material. Shtrohet pyetja se çfarë sekreti afarist përbëjnë disa nga dokumantat siç janë por jo vetëm: kontratat e punëve të cilat sipas LPP-së janë publike dhe të qasshme për publikun, afati i skadimit të regjistrimit të mjeteve dhe pajisjeve i cili është publik përmes stikersave të cilat me vendim të qeverisë janë të obliguara të vendosen në pjesën e përparme të mjetit, modeli/marka dhe kapaciteti i mjeteve dhe pajisjeve të cilat janë publike e shihen me sy, etj.

Ndersa ne pikpamje ligjore nga ana e AK-së nuk iu eshte kerkuar OE ne fjale qe te plotesojne kushtet e lartshenuara ligjore qe ndodhen ne formularin e Anex-it 3 te dosjes se tenderit si dhe nuk ka bërë një test të dëmit dhe interesit publik për të përcaktuar nëse dëmi i shkaktuar interesit të mbrojtur mbisundon interesin e publikut për qasje në atë dokument publik. Po ashtu Informacionet si të pretenduara si sekret afarist nuk jane klasifikuar si informacione sekrete afariste siç percaktohet ne nenin 11 par.4 te LPP-se.

Po ashtu nga ana AK-së deri pak orë para se ta dorëzojmë këtë kërkesë nuk na është siguruar as Raporti i Komisionit Vleresues perkunder se të njejtin ka detyrim ligjor ta ngarkojë ne platformen e-prokurimi gjë që nuk e ka ngarkuar.

Në këtë mënyrë, AK ka shkelur dispozitat e nenit 10 par.3 dhe 4 dhe nenit 11 par. 3 dhe 4 të LPP-së, sepse na ka pamundësuar dhe kufizuar realizimin e të drejtave për qasje në dokumente publike sipas kërkesës e cila përtej dispozitës së nenit 10 të LPP-së është e garantuar edhe me Ligjin Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Pretendimi Nr.4.

Me vendimin e kontestuar me anë të cilit është anuluar aktiviteti i prokurimit pa egzistuar asnjëra nga rrethanat dhe kërkesat ligjore të kërkuara me nenin 62 të LPP-së, konsiderojmë se AK është duke rrezikuar sigurinë juridike dhe pritshmërinë legjitime dhe të arsyeshme për faktin se po krijon përshtypjen sikurse vendimet e AK-së janë të karakterizuar nga interesa të tjera e jo ato ligjore. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit nga ana e AK-së në mënyrë të pajustifikuar e duke e keqpërdorur diskrecionin ligjor ka filluar që të bëhet rregull dhe praktikë e përditshme. Sikurse në shumë raste tjera edhe në rastin konkret veprimet dhe vendimet e AK-së nuk jan ëas për së afërmi në përputhje me kërkesat procedurale e qenësore të këtij ligji mirëpo bien ndesh me parimet e bazike të prokurimit publik siç janë: drejtësia, objektiviteti, transparenca dhe standardet profesionale.

Në këtë mënyrë, konsiderojmë se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së dhe nenin 4.3 të RRPP nr.001/2022.

Pretendimi Nr. 5 lidhur me Vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim

Autoriteti Kontraktues përmes e vendimit të datës 08.11.2022 e ka refuzuar si të pabazë Kërkesën për Rishqyrtim të ankuesit OE EL-BAU Sh.p.k. me seli në Gjilan.

Arsyetimi i vendimit të kontestuar nuk mbështetet apo plotësohet me asnjë provë që do të arsyetonte këtë arsyetim. Kërkesa për Rishqyrtim refuzohet duke parafrazuar arsyetimin e vendimit për anulim i cili është bazuar vetëm në supozime dhe pretendime imagjinative përmes paraqitjes së fakteve/situatave të paqena/rrejshme. Si dhe duke parafrazuar pas asnjë kuptim e logjikë dispozitën e nenit 44.3 të Rregullorës Nr.001/2022.

Si i tillë vendimi i kundërshtuar nuk i përman dhe nuk i përmbush as elementet që duhet t'i përmbajë arsyetimi i një vendimi. Në këtë kuptim, arsyetimi i vendimit kontestues nuk është në përputhje me kriteret ligjore të parapara me nenin 108/A paragrafi 12 të LPP-së. Posaqërisht është në kundërshtim me dispozitën e nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili , ka përcaktuar qartë se çfarë duhet të përmbajë arsyetimi i një akti administrativ.

Paragrafi 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;
1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;
1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;
1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;
1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;
1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

Në rastin konkret, AK i ka injoruar në tërësi të gjitha pretendimet ankimore dhe faktet e rëndësishme për këtë çështje të paraqitura në kërkesë. Po ashtu i ka anashkaluar detyrimet ligjore duke mos e argumentuar me asnjë provë te vetme shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, se në cilat prova është bazuar dhe cila ka qenë baza ligjore në të cilën e ka bazuar arsyen e vendimit dhe pse është e zbatueshme në rastin konkret.

Gjendja faktike ndryshon nga arsyetimi i bazuar vetëm në supozime dhe pretendime imagjinative i vendimit të kontestuar të autoritetit kontraktues. Vendimi i AK-së është në kundërthënie të plotë me gjendjen faktike dhe kërkesat ligjore për faktin se procesi anulohet në fazën e dhënies së kontratës me justifikime të shpikura nga imagjinatat e AK-së duke paraqitur fakte/situata të paqena dhe duke keqzbatuar dispozitën e nenit 62 të LPP-së.

Andaj një vendim i tillë mbetet të kuptohet vetëm si pretendim i argumentuar pasi sikurse thekoshet në në paragrafin 2 të nenit 48 të LPPA-së, arsyetimi është i barabartë me mungesën e tij kur është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës dhe i pakuptueshëm

Përfundim me propozime

Në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të sipërtheksuara, rezulton se vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është i padrejtë dhe i kundërligjshëm. Dhe si i tillë neve si palë na ka sjellur dëm në atë mënyrë që rrezikon ta dëmtojë në atë masë e cila do të jetë e parikuperueshme.

Sipas Rregullorës për Prokurim Publik Nr.001/2022:

- *Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së përbën shkelje të rëndë ligjore sipas nenit 96 pika k) të RRPP Nr.001/2022.*
- *Moslejimi dhe neglizhimi qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të LPP-së, përbën shkelje të rëndë ligjore sipas nenit 96 pika c) të RRPP Nr.001/2022*
- *Neglizhimi i afateve kohore për vlerësimin e tendërëve përbën shkelje të lehtë nga neni 96 pika b) të RRPP Nr. 001/2022*

Duke qenë se nga ana e AK-së nuk ka pasur reflektim dhe nuk janë ndërmarrë veprime korrigjuese me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë në atë mënyrë që procesi të vazhdohet në pajtim me kërkesat ligjore të LPP-së dhe RRPP Nr.001/2022, ankuesi OE "El-Bau" detyrohet që t'i drejtohet OSHP-së me këtë ankesë, duke kërkuar që pas administrimit të provave në shqyrtim fillestar dhe shqyrtim kryesor, e në pajtim me nenin 105 par.2.8 dhe 2.10, neni 106 dhe neni 116 i LPP-së, të merr këtë

VENDIM

1. **MIRATOHET E BAZUAR** në tërësi Ankesa e ankuesit OE "EL-BAU" Sh.p.k
2. **DETYROHET AK- Komuna e Gjilanit ta ANULOJË** Njoftim Vendimi i dt. 11.01.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe ta **ANULOJË** Vendimin e 18.01.2023 me anë të cilit është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e ankuesit OE "EL-BAU" Sh.p.k
3. **DETYROHET AK- Komuna e Gjilanit** që lëndën ta kthej në **RIVLERËSIM** duke e detyruar që të korrigjojë shkeljet e pretenduar dhe të ndërmerr masa korrigjuese në atë mënyrë që procesi të vazhdohet aty ku ka ngelur, me shpalljen e rezultatit të aktivitetit të prokurimit përmes Njoftimit për Dhënien e Kontratës.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

N/A

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
OE ankues është i pasuksesshëm

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

OE i pa kënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues paraqet ankesë në OSHP, me arsyetimin se janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së.

Eksperti shqyrtues, sqaron se autoriteti kontaktues pas pranimit të ofertave ne sistemin e e-prokurimit, ka formuar komisioni për vlerësimin e ofertave i cili ka konstatuar se ka gabime në listën e përshkrimit të çmimeve – parallogari dhe paramasë dhe se ky gabim sipas komisioni vlerësues në ketë fazë është i pariparushem. Me datën: 11.01.2023 zyrtari përgjegjës i prokurimit e publikon ne sistemin e e–prokurimit, njoftimin mbi vendimin ne AK-se, me të cilin e anulon në tërësi aktivitetin e prokurimit në fjale.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar paramasën ka vërejtur se, AK-ja, nuk e ka dhëne formulën në të gjitha pozicionet e paramasës, konkretisht krahut nr. 3 dhe për pasoje nuk është llogaritur fare.
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues e ka vërejtur dhe ka ndërhyrë në paramasë duke e llogaritur edhe totalin e krahut nr. 3 të paramasës, ndërsa OE i dyti me radhë e ka vendosur çmimin e në krahun nr. 3 por si pasoje e gabimit në formulën e paramasës nuk është llogaritur totali dhe në ketë mënyrë OE-të, që nuk e kanë vërejtur nuk kanë qene të barabarte në këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, vjen në përfundim se AK-Komuna e Gjilanit me rastin e hartimit të dosjes së tenderit konkretisht paramasës, nuk ka vepruar në harmoni me nenin 27 të LPP-se dhe njëherit sqaron se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet sepse dosja e tenderit është hartuar në kundërshtim me nenin 27 te LPP-së, konkretisht në kundërshtim me nenin 47.14 të RrUOPP-se, citat:

47.14 Autoriteti kontraktues duhet të marrë një qasje të ngjashme jo-kufizuese kur zbulon se dosja e tenderit që ka lëshuar mund të ketë mangësi të caktuara ose mund të jetë më pak e qartë në disa pika. Kjo megjithatë nuk duhet që në asnjë rrethanë të çojë në ndonjë ndryshim de facto në kërkesat teknike dhe të tjera të dosjes së tenderit. Nëse autoriteti kontraktues vjen në përfundimin se tenderi i planifikuar është në fakt i papërshtatshëm atëherë ajo nuk do të jetë e mundur për të "riparuar" në dosjen e tenderit me anë të informacionit shtesë ose sqarime. Qasja e vetme në dispozicion në situata të tilla është që të anulojë tenderin dhe të fillojë një procedurë tjetër në bazë të një dosjeje të tenderit të ndryshuar.

OE "El-BAU", pretendon se aktivitetet e prokurimit te zhvilluara nga ana e Autoriteti Kontraktues gjatë fazës së vlerësimit si dhe marrjes përfundimtare të vendimeve, nuk ka përfunduar brenda afateve ligjore, duke cituar se: nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK-së do të kryhet brenda periudhës me të shkurtër kohore, jo me shume se 30 dite nga hapja e ofertave. Nga procesi i hapjes se tenderit me datën 05.12.2022 dhe deri te nxjerrja e vendimit për anulim te aktivitetit ka zgjatur 37 dite.

Eksperti shqyrtues për pretendimin e cituar me larte, vlerëson se qëndron për faktin se sipas nenit 41.2 të RrUOPP-se, vlerësimi i ofertave do te zgjasë jo me shume se 30 dite dhe duhet te filloje brenda 5 ditëve pas hapjes se ofertave.

OE ankuese, pretendon se pas pranimit të vendimit të datës 11.01.2022 për anulimin e aktivitetit të prokurimit: ***Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish,*** është kërkuar qasje në dokumente zyrtare nga AK. Pas aprovimit të kërkesës nga AK për qasje në dokumente zyrtare, OE ankuese konsideron që: nuk është lejuar qasja ne dosjet tenderues siç parashihet ne nenin 10 dhe 11 të LPP-së, me arsyetimin se është parashtruar kërkesë për sekrete afariste. OE pretendon se OE "Company Zuka" dhe OE " Tali" ne asnjërën prej kërkesave të tyre nuk janë identifikuar/referuar dokumente apo informacione si sekrete afariste si dhe nga Autoriteti Kontraktuese nuk është kërkuar nga OE ne fjalë qe te plotësojë formularin e Anex-it 3.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron të dy OE-të për të cilët ka pretenduar OE ankues, i kanë dorëzuar kërkesat për sekret afarist, të cilët në kërkesat e tyre, i kanë përcaktuar të gjitha kërkesat mbi mundësit ekonomike dhe financiare dhe kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale.
Sa i përket këtij pretendimi eksperti shqyrtues sqaron se qëndron ky pretendim i OE ankues, për faktin se nuk mund të kualifikohen të gjitha dëshmit e kapacitetit teknik dhe profesional si sekrete afariste.

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE *"Company Zuka Commerce" sh.p.k* , duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:
Oferta financjare , dokumenti mbi gjendjen ekonomike dhe financjare dhe dokumenti mbi mundesit teknike dhe profesionale .

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE *[emri i operatorit ekonomik]* (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:
Oferta financiare dok.mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe dok. Mbi mundesit teknike dhe profesionale

Eksperti shqyrtues në fund të vlerësimit të pretendimeve ankimore, sqaron se ankesa është pjesërisht e bazuar lidhur me shkeljet procedurale të cilat u sqaruan më larte, ndërsa pretendimi kryesore lidhur me anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit nuk qëndron për faktin se gjate përpilimit të dosjes së tenderit nuk janë respektuar dispozitat e nenit 27 te LPP-se dhe neni 47.14 te RrUOPP-se.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "El-BAU", të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK Gjilan;
- Panelit Shqyrtues – OSHP;
- OE ankues - "El-BAU" .